Përmbajtja

	Faqe i
• Raporti i audituesve te pavarur	3
• Bilanci kontabël më 31 Dhjetor 2013	5
• Pasqyra e te ardhurave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	6
• Pasqyra e ndryshimeve ne kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	7
• Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	8 – 34
• Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për fundin e vitit 31 Dhjetor 2013	

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për **Aksionerët dhe drejtuesit e shoqërisë**
OST sha, Tiranë
Bulevardi Gjergj Fishta
Tiranë, Shqipëri

Raport mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të bashkangjitura të shoqërise OST sha Tiranë, (në vijim referuar si "Shoqeria") dhe të filialeve të saj, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të prarasë për vitin e përfunduar në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacionet e tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin e kryer. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesit marrin në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të shoqërisë me qëllim që të përcaktojnë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë të politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për rezervën në opinionin tonë të auditimit.

Baza për Opinionin me rezervë

Sic përmendet në shënimin 15 të pasqyrave financiare, huatë e shoqërisë nuk janë paraqitur me vlerën e drejtë sipas kërkesave të SNk 39 "Instrumentat financiare, Njohja dhe Matja". Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë efektet kontabël që mund të vijnë si pasojë e vlerësimit të huave me vlerën e drejtë.

Gjithashtu në akt rakordimin e Shoqërise OSHT sha me KESH sha, rezulton një diferencë prej 159,599 mijë Lekë në zërin e huave. Kjo shumë përfaqëson pagesat e bëra në Dhjetor 2011 nga OST sha në llogari të Njësisë së Tatim Paguesve të Mëdhenj, në bazë të Njoftimit për Veprim Ligjor në datë 28.12.2011, në emër dhe për llogari të KESH sha, për detyrimet që kjo e fundit ka patur për TVSH. KESH sha nuk e njeh këtë shumë si ulje të huasë mes shoqerive. Si rrjedhim, në mungesë të dakortësisë mes palëve ne nuk ishim në gjendje të vlerësonim nëse shoqeria duhet të njohë ndonje provizion në lidhje me këtë shumë.

Opinioni me rezervë

Sipas opinionit tonë, me perjashtim të efekteve të cështjeve të përshkruara në paragrafin e Bazës për opinion me rezervë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë "OST" sha me datën 31 Dhjetor 2013, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Tiranë, 28/05/2014

Ekspertët kontabël të autorizuar

Sabina Shytaj

Theodhoraq Gjosha

Eneida Rrahmani

Hysen Çela

Sokol Toska

ERK AUDITING sh.p.k
K91713008K
IEKA
Tirana - Albania

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
Eneida Saliaj
(Rrahmani)
Liç.Nr. 158

Operatori i Sistemit te Transmetimit

Bulevardi. Bajram Curri
Rruga Viktor Eftemiu,
ish godina e KESH sh.a.
Tirane, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581

Operatori Sistemit te Transmetimit Sh.a Tirane

Pasqyra e Pozicionit Financiar
per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	Shenime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	38,820,960,337	39,090,052,547
Aktive afatgjata jomateriale	7	52,610,041	2,640,030
Investime financiare afatgjata	8	17,461,038	18,225,038
Aktive financiare afatgjata	9	104,383,920	205,615,091
		39,995,415,336	**39,316,532,706**
Aktivet Afatshkurtra			
Inventari	10	907,152,587	675,987.412
Aktive te tjera financiare afatshkurtera	11	6,817,366,179	5,494,615,392
Te tjera te arketueshme	9	151,846,756	101,231,170
Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra	12	2,070,374,903	274,416,220
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	13	466,167,837	123,506,108
Hua dhe parapagime	15		
Tatim aktual I paguar teper	20	22.518,093	
		10,435,426,355	**6,669,756,303**
Totali I aktiveve		**49,430,841,691**	**45,986,289,009**
Kapitali neto dhe detyrimet			
Kapitali			
Kapitali aksionar	14	9,694,008,000	6,564,667,000
Rezerva ligjore		364,791,062	252,339,978
Rezerva rivlersimi		10,831,146,267	10,831,146,266
Rezerva te tjera		471	1,217,673,046
Fitime/humbje te pa shperndare			
Fitime/humbje te vitit financiar		1,564,720,160	2,249,021,675
Totali I kapitalit neto		**22,454,665,960**	**21,114,847,965**
Detyrimet afatgjata			
Huate afatgjata	15	14,602,387,714	18,963,539,886
Llogari te pagueshme tregtare e te tjera afatgjata	16	404,502,255	600,849,458
Grantet e te ardhura te shtyra	17	659,906,172	640,747,437
Tatime te shtyra per PPE	19	1,550,348,099	1,018,247,974
Totali I pasiveve afatgjata		**17,217,144,240**	**21,223,384,755**
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregetare dhe llog te tjera te pagueshme	18	2,544,704,826	2,177,953,188
Hua dhe parapagimet	15	7,214,326,665	1,425,806,866
Tatim aktual i paguar teper	20	0	44,296,236
Totali I pasiveve		**9,759,031,491**	**3,648,056,89**
Totali I kapitalit neto dhe pasiveve		**49,430,841,691**	**45,986,289,009**

Drejtore Ekonomike
Syphije XHEPA

Shefe Kontabiliteti
Merita PULLA

Administrator i OST
Engjëll ZEQO

Bulevardi. Bajram Curri
Rruga Viktor Eftemiu,
ish godina e KESH sh.a.
Tirane, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581

Operatori Sistemit te Transmetimit Sh.a Tirane

Pasqyra e te Ardhurave Gjitheperfshirese
per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	Shenime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Shitjet neto	21	5,531,117,576	5,765,926,576
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	22	3,285,815	1,474,661
Ndryshimet ne Inventarin e prodhim proces		-	-
Mallra, lende te para e sherbime	23	(517,523,001)	(573,152,448)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	24	(350,109,076)	(268,739,277)
Shpenzime te Personelit	25	(706,085,955)	(686,935,951)
Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	6, 7	(1,557,583,255)	(1,482,285,223)
		-	-
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		**2,403,102,104**	**2,756,288,338**
Te ardhurat e shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara			
Te ardhurat e shpenzimet financiare nga pjesemarrjet			
Te ardhurat e shpenzimet financiare	26	(37,144,442)	(191,619,428)
		-	
Totali i te ardhurave e shpenzimeve financiare		**(37,144,442)**	**(191,619,428)**
Fitimi (humbja) para tatimit		**2,365,957,663**	**2,564,668,910**
Shpenzimet e tatimit te fitimit	27	(269,137,377)	(286,814,235)
Shpenzimet e tatimit te shtyre	20	(532,100,125)	(28,833,000)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		**1,564,720,160**	**2,249,021,675**

Drejtore Ekonomike
Syphije XHEPA

Shefe Kontabiliteti
Merita PULLA

Administrator i OST
Engjëll ZEQO

Operatori i Sistemit te Transmetimit

Bulevardi. Bajram Curri
Rruga Viktor Eftemiu,
ish godina e KESH sh.a.
Tirane, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581

Operatori Sistemit te Transmetimit Sh.a Tirane

Pasqyra e Kapitaleve te Veta
per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

	Kapitali Nenshkruar	rezerva nga rivl	Rezerva Ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pasherndare	Totali
Gjendja me 31 Dhjetor 2012	4,828,402,000	11,841,558,266	182,604,764	710	1,395,057,190	18,247,622,930
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabel						-
Saktesime					**(352,920)**	(352,920)
Zmadhim kapitali	1,736,265,000					1,736,265,000
Fitimi neto per periudhen ushtrimore					2,249,021,677	**2,249,021,675**
Dividendet e paguar					(139,469,720)	**(139,469,720)**
Rritje e rezerves se Kapitalit			69,735,214	1,185,499,337	(1,255,234,551)	-
Tatim I shtyre per humbje nga rivlersimi					32,173,000	**32,173,000**
Tatim I shtyre per rezerven e rivlersimit		(1,010,412,000)				**(1,010,412,000)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2012	**6,564,667,000**	**10,831,146,266**	**252,339,978**	**1,185,500,047**	**2,281,194,676**	**21,114,847,967**
Saktesime						-
Zmadhim kapitali	3,129,341,000			(3,129,341,000)		-
Fitimi neto per periudhen ushtrimore					1,564,720,160	**1,564,720,160**
Dividendet e paguar					(224,902,168)	**(224,902,168)**
Rritje e rezerves se Kapitalit			112,451,084	1,943,841,424	(2,056,292,508)	-
Saktesime						
Tatim I shtyre per rezerven e rivlersimit						-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	**9,694,008,000**	**10,831,146,266**	**364,791,062**	**471**	**1,564,720,160**	**22,454,665,959**

Drejtore Ekonomike
Syphije XHEPA

Shefe Kontabiliteti
Merita PULLA

Administrator i OST
Engjëll ZEQO

OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT

Bulevardi. Bajram Curri
Rruga Viktor Eftemiu,
ish godina e KESH sh.a.
Tirane, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581

Operatori Sistemit te Transmetimit Sh.a Tirane

Pasqyra e Flukseve te Parase
per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitim / Humbja para tatimit	2,365,957,663	2,564,668,910
Rregullime per:		
Amortizimi dhe zhvleresimi	1,557,583,255	1,482,285,223
Shpenzimet e interesave	142,118,348	198,511,973
(Rritja)/ Ulja e inventareve	(231,165,175)	(18,305,531)
(Rritja) / Ulja e te kerkesave te arketueshme(aktive afta shkurtra)	(1,373,366,381)	(2,286,731,831)
(Rritja) / Ulja e te kthyeshmeve te tjera	(1,795,958,761)	120,261,718
Rritja/(Ulja) e detyrimeve per tu paguar	366,762,075	568,183,180
Rritja/(Ulja) e detyrimeve te tjera	308,194,803	(204,230,959)
Interesi i Paguar	(5,479,048)	(192,795,832)
Tatim fitimi i paguar	(289,244,852)	(266,332,713)
Tatim I shtyre	(532,100,125)	
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit	**513,301,802**	**1,965,514,138**
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese		
Blerje e shoqerise se kontrolluar minus parate e arketuara		
Blerje prona dhe aktive	(1,525,803,737)	(2,520,377,317))
Te ardhura nga shitja e pajisjeve/Saktesime	187,342,335	39,168,124
Investime		
Rivlersim I aseteve		
Paraja neto nga aktivitetet investuese	**(1,338,461,403)**	**(2,481,209,193)**
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare		
Te ardhura nga shlyrja e huave(kredi shtepie)	764,000	1,315,800
Te ardhura nga huamarrje afat-gjata	101,231,171	101,231,170
Disbursime te kredive gjate vitit	1,290,728,327	181,318,609
Teperice rivlersimi		
Dividendet e paguar	(224,902,168)	(139,469,720)
Rritje ne kapital		
Paraja neto nga aktivitetet financiare	**1,167,821,330**	**144,395,859**
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	**342,661,730**	**(371,299,196)**
Mjete monetare ne fillim te periudhes ushtrimore	**123,506,108**	**494,805,303**
Mjete monetare ne fund te periudhes ushtrimore	**466,167,838**	**123,506,108**

Drejtore Ekonomike
Syphije XHEPA

Shefe Kontabiliteti
Merita PULLA

Administrator i OST
Engjëll ZEQO

Operatori i Sistemit te Transmetimit

Bulevardi. Bajram Curri
Rruga Viktor Eftemiu,
ish godina e KESH sh.a.
Tirane, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581

Operatori Sistemit te Transmetimit Sh.a Tirane

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare te vitit te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 *(shuma ne leke)*

1. Historiku i Shoqërisë

Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a.ka përgjegjësinë e vetme të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri. OST aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 6 degëve dhe drejtorisë.Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat e shoqërisë .Shoqëria u krijua si shoqëri anonime në korrik 2004 bazuar në vendimin nr.797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003. Në bazë të këtij vendimi njësia do të themelohej si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a ("KESH" ose "Shoqëria Mëmë"). Kapitali fillestar, 2 milion Lekë, u regjistrua dhe pagua në korrik 2004.

Në vitin 2006 Shoqëria mori liçencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH-in. Ndarja u krye bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 30 qershor 2006. Shoqëria përgatiti pasqyra financiare te konsoliduara si një njësi ekonomike e veçantë që nga 1 korriku 2006 dhe jo që nga viti 2004 kur nisën të kryheshin transaksionet e para të Shoqërisë.

Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë ("Ministria") datë 9 maj 2008, pronësia e OST kaloi nga KESH sha METE. Duke ndjekur instruksionin nr 10540/17 te Ministrisë, OST u nda nga KESH nga data 1 janar 2008.

Mbështetur në vendimin Nr. 20, datë 10 nëntor 2010 të Këshillit Mbikëqyrës, u krijua shoqëria OST Security Sh.a. me nje kapital fillestar prej 4 milion lekë, të zotëruar 100% nga OST. OST Security u regjistrua në QKR më 1 dhjetor 2010.Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është ruajtja e objekteve ne pronësi dhe administrim të OST.

Ne baze te Urdherit te Aksionerit e Vetem, Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes nr.750 date 07.10.2011 "Per zmadhimin e kapitalit te sh.a Operatori i Sistemit te Transmetimit" eshte bere zmadhimi i kapitalit themeltare te OST sh.a me vleren 3.125.347.000 leke. Ky veprim eshte pasqyruar ne QKR ne daten 8.11.2011.

Ne baze te Urdherit te Aksionerit e Vetem, Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes nr.331 date 20.04.2012 "Per zmadhimin e kapitalit te sh.a Operatori i Sistemit te Transmetimit" eshte bere zmadhimi i kapitalit themeltare te OST sh.a me vleren 1.406.016.000 leke.

Ne baze te Urdherit te Aksionerit e Vetem, Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes nr.706 date 31.10.2012 "Per zmadhimin e kapitalit te sh.a Operatori i Sistemit te Transmetimit" eshte bere zmadhimi i kapitalit themeltare te OST sh.a me vleren 330.249.000 leke.

Ne baze te Urdherit te Aksionerit e Vetem, Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes nr.720 date 4.09.2013 "Per zmadhimin e kapitalit te sh.a Operatori i Sistemit te Transmetimit" eshte bere zmadhimi i kapitalit themeltare te OST sh.a me vleren 3,129,341,000 leke

Kapitali Themeltar I shoqerise nga6,564,667,000 leke behet 9,694,008,000 leke , i barabarte me 9,694,008 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.

Objekti i aktivitetit te OST sh.a i percaktuar ne statutin e shoqerise eshte :

- Operimin e rrjetit te transmetimit nga pikpamja fizike (posedim, mirembajtje dhe zgjerim) (ORrT);
- Operimin e Sistemit nga pikepamja e dispecerimit (OS);
- Operimin e Tregut (duke siguruar qe informacioni per likuidimin e kontratave është i disponueshem, qe me pas mund te sherbeje si nje burse e energjisë elektrike)."

Administratori i shoqerise eshte Z. Engjëll Zeqo

Shoqeria eshte subjekt i tatimpaguesve te medhenj me NIPT K42101801N, kodi fiskal 3709539.
Selia ekzistuese e shoqërise është vendosur ne Bulevardi "Bajram Curri",rruga Viktor Eftimiu ish godina KESH sh.a Tirane, Shqiperi.
Numri i punonjësve në 31 Dhjetor 2013 eshte 727 (nr.Fizik) dhe numri mesatar vjetor eshte 722 (724 punonjes ne vitin 2012).

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike.Aktivet Afat Gjata Materiale jane matur me vleren e drejte, efektet e ketij vlersimi jane pasqyruar ne pasqyrat financiare te vitit 2011.

(c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme.Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.Në veçanti, informacionet mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara përshkruhen në shënimin 5.

3. Përmbledhja e politikave kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të njëjtë nga të gjitha njësitë.

(a) Baza e konsolidimit (Njesite Opertaive)

(i) Njesite

Njesit operative janë njësi të kontrolluara nga Shoqëria.Kontrolli ekziston atëherë kur Shoqëria ka fuqinë të drejtojë politikat financiare dhe operacionale të një njësie, me qëllim që të përfitojë nga aktivitetet e saj.Në vlerësimin e kontrollit, merren në konsideratë të drejtat potenciale votuese që janë aktualisht në fuqi.Pasqyrat financiare të njesive janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e mbarimit të tij.Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar ne politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta.

(ii) Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit

Tepricat brenda grupit, dhe ndonjë shumë e parealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit, janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Fitimet e parealizuara janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara.Humbjet e parealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit.Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos të amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos të amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës.Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë.Diferencat e kursit të këmbimit nga rikonvertimi njihen si fitim ose humbje.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
1 EUR	140.20	139.59
1 USD	101.86	105.85
1 CHF	114.41	115.65
JPY	0.9698	

(c) Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto.Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e kostos mesatare të ponderuar dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit apo të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.Kostoja e inventarit mund të përfshijë edhe transferime nga të ardhurat e tjera përmbledhëse të ndonjë fitimi apo humbjeje nga mbrojtjet e kualifikuara të flukseve monetare për blerje të inventarit në monedhë të huaj.

(d) Aktivet afatgjata materiale

- *Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale janë matur me kosto, pakësuar më pas me amortizimin dhe zhvlerësimin. Kosto e disa prej zërave të aktiveve afatgjata materiale është përcaktuar duke iu referuar një rivlerësimi të kryer sipas PPPK-ve të mëparshëm. Gjatë kalimit të saj drejt SNRF-ve më 1 janar 2006, Shoqëria zgjodhi të përdorë mundësinë e vlerës së drejtë si kosto të gjykuar për këta zëra të aktiveve afatgjata materiale.Kosto përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit.Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të punës së drejtpërdrejtë, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për përdorimin e synuar, kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit dhe kostot e kapitalizuara të huave.Programet e blerë që janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjeve me të cilat lidhen kapitalizohen si pjesë e atyre pajisjeve.

Kur pjesët e një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (pjesë kryesore) të aktiveve afatgjata materiale.Humbja apo fitimi nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit e një pjese të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar çmimin e shitjes dhe vlerën kontabël të aktiveve afatgjata materiale dhe njihen për vlerën neto në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

Bazuar ne raportin e rivlersimit te aseteve i miartuar me shkresen Nr.5069/1 date 1.06.2011 i METE aktivet afat gjata materiale jane matur me vleren e drejte dhe efektet e ketij rivlersimi jane pasqyruar ne pasqyrat financiare te vitit 2011.

- *Kostot vijuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse pritet që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e saj mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

- *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afat gjata material llogaritet me metoden lineare duke u bazuar ne jete gjatesin e percaktuar te cdo aktivi,njekohesisht shoqeria lloagarit amortizim edhe sipas noramve fiskale duke pasqyruar efektet e tyre tek aktivet dhe pasivet tatimore te shtyra.

• Përmirësimet e tokës dhe ndërtesat	16 - 40 vite
• Instalime teknike, pajisje dhe makineri	4 - 41 vite
• Linja te TL	50-55 vite
• Mjete transporti	5 - 12 vite
• Pajisje zyre dhe informatike	5 - 14 vite

Toka dhe ndërtimet në proces dhe nuk amortizohen.

(e) Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jo-materialete blerë nga Shoqëria janë matur me vleren e drejte. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhet.Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve afatgjata jo-materiale.Jetëgjatësia e parashikuar është 5 vite.

(f) Instrumentet financiarë

i. Aktivet financiare jo derivative

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen.Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar transferohen.Ndonjë interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

ii. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjerat

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuara në një treg aktiv.Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet monetare gjendje si dhe depozitat në të parë me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Llogaritë debitore bankare të pagueshme në të

parë që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të menaxhimit të mjeteve monetare të Shoqërisë përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalente me to në pasqyrën e flukseve monetare.

iii. Detyrimet financiare jo të prejardhura

Shoqëria fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare jo të prejardhura të Shoqërisë janë si vijon: hua, llogari bankare debitore dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Shpenzimet e lidhura me kreditë (interesit dhe tarifat e tjera) janë të përfshira në Deklaratën e Burimeve dhe në Pasqyrën për Përdorimin e Fondeve (si në rastet kur është lidhur një marrëveshje nënhuaje midis KESH apo Ministrisë së Financave).

Principali i kredisë, në qoftë se është paguar gjatë vitit përkatës, është përfshirë si : kontributi i KESH / OST në pasqyrën e "Burimi i fondeve" dhe si shpenzim në pasqyrën e "Përdorimit të Fondeve".

Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin.

(g)Kostot e huamarrjes

Shoqëria kapitalizon kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar si pjesë e kostos së atij aktivi.

(h)Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo të tërthortë, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkohen flukse dalëse parash për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të detyrimit.

(i)Subvencionet

Subvencionet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Shoqëria do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur subvencionit. Subvencionetqë kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet.Subvencionet që kompensojnë koston e aktiveve të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

(j)Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre.Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavaruara nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve ("njësia e gjenerimit të parasë" ose NGP).

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e NGP-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme.Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NGP-të shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grupin e njësive) në mënyrë përpjestimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më.Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(k)Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se një ngjarje e cila ka sjelle humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare te aktivit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë mospagimin apo vonesat në pagesë nga debitorët, ristrukturimin e një shumë për t'iu paguar Shoqërisë me terma të cilat Shoqëria nuk do t'i pranonte në një rast të kundërt si dhe treguesit që një debitor ose emetues do të shkojë në falimentim.

Shoqëria konsideron evidencë zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme në nivel specifik dhe kolektiv.Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të mëdha vlerësohen në mënyrë specifike për zhvlerësim.Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të mëdha që nuk zhvlerësohen në mënyrë specifike, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por që nuk është identifikuar ende. Llogaritë e arkëtueshme individualisht jo të mëdha vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar bashkë llogaritë e arkëtueshme me karakteristika të ngjashme rreziku.

Në përcaktimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor tendencën historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, korrigjuar sipas gjykimit të drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies janë të tilla që humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Një humbje nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme monetare të ardhshme skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit.Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provizioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim ose humbje.

(l)Kapitali aksioner

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

(m)Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të njësisë ekonomike që rezultojnë në rritje të kapitalit gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e

kapitalit në sajë të kontributeve të aksionerëve.Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë.Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet.

Kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, Shoqëria i njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për energjinë e transmetuar (shiko Shënimin 5.2).Shuma e të ardhurave nuk konsiderohet si e matshme në mënyrë të besueshme derisa të jenë zgjidhur të gjitha pasiguritë e lidhura me shitjen.Shoqëria i bazon vlerësimet e saj në rezultatet historike, duke mbajtur parasysh llojin e klientit, tipin e transaksionit dhe specifikimet e çdo marrëveshjeje.

(n)Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit.Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi kreditë, diferencat nga skontimi i provizioneve, humbjet e njohura nga zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe humbjet nga kursi i këmbimit.Kostot e huave që nuk janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv.Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi bazë neto.

(o)Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë.Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore.Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabel dhe as ato tatimore.Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës për shumën neto ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren.

Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(p)Përfitimet e punonjësve

- *Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria.Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- *Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Shoqëria është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje, ndaj një plani zyrtar të detajuar për përfundim të punësimit para datës së zakonshme të daljes në pension apo që të ofrojë përfitime në përfundim të marrëdhënies së punës për të stimuluar largimin vullnetar. Përfitimet në përfundim për largim vullnetar njihen si shpenzim nëse Shoqëria ka bërë një ofertë për stimulimin e këtij largimi, ka mundësi që oferta të pranohet dhe numri i pranimeve mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

(q)Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative.Pagesat e qirave operative (pasi i zbriten stimujt e vendosur nga qiramarrësi) njihen me metodën lineare në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë.

(r)Shpërndarja e dividendëve

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

Ndryshimet në SNK 12 sigurojnë një përjashtim nga parimi i përgjithshëm i cili përcaktohet në SNK 12 "*Tatimet mbi të Ardhurat*" qe matja e tatimit të shtyrë duhet të duhet të pasqyrojë mënyrën në të cilën njësia ekonomike pret të rikuperojë vlerën kontabël të një aktivi. Konkretisht ndryshimet percaktojne një hipotezë të kundërshtueshme qe vlera kontabël e një aktivi afatgjat material te investuar matet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 "Investimi ne Aktivet Afatgjata Materiale" do të mbulohen tërësisht nëpërmjet shitjes. Ndryshimet janë kryer në përgjigje të shqetësimeve se aplikimi i qasjes se përgjithshme te SNK 12 mund të jetë i vështirë apo subjektiv për aktivin afatgjat material te investuar të matur me vleren e drejtë, sepse ajo mund te ndodhe qenjësia ekonomike synon ta mbajë aktivin për një periudhë të pacaktuar ose të papërcaktuar kohore, gjatë se ciles ajo parashikon edhe të ardhura nga qiraja dhe vlerësimin i kapitalit.

Sipas ndryshimeve, me perjashtim nëse supozimi hidhet poshtë, matja e tatimit të shtyrë duhet të reflektoje pasojat tatimore të rimarrjes se vlerës kontabël të aktivit afatgjat te investuar, tërësisht nëpërmjet shitjes. Supozimi i shitjes kundërshtohet neqoftëse aktivi i investuar është i amortizueshem dhe aktivi i investuar mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është konsumini kryesisht i të gjitha përfitimeve ekonomike të trupëzuara në aktivin e investuar me kalimin e kohës dhe jo përmes shitjes.

Pas zbatimit të ndryshimeve, Shoqerite te cilat mbajnë aktivin afatgjat material te investuar te kontabilizuar duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në përputhje me SNK 40, në juridiksione ku tatimi nuk është i imponuar në shitje të aktivit te investuar, nuk do të njohë me tatim të shtyre mbi diferencat e përkohshme që rrjedhin nga fitim humbjet permes vleres se drejtë (pervec rasteve kur supozimi është hedhur poshtë).

Kjo është për shkak se nuk duhet të ketë pasoja tatimore që priten të lindin nga rekuperimi i vlerën kontabël tërësisht nëpërmjet shitjes, pavarësisht nëse njësia ekonomike synon të përdorë aktivin për të gjeneruar të ardhura nga qiraja për një periudhë kohe para shitjes.

Për aktivin e investuar te amortizuar, zbatimi i ndryshimeve do të rezultojë në një ndryshim të politikës kontabël. Kur tatimi i shtyrë lidhur me një aktiv te investuar është përcaktuar më parë në bazë të pritjeve se aktivi do të rimerret përmes përdorimit, baza e matjes do të duhet të ndryshohet me perjashtim kur supozimi I shites është hedhur poshtë. Kur amendamentet kërkojnë aplikim te plote te matjes retrospektivisht dhe efekti është material, vlerat e vitit paraardhes janë të nevojshme për zbatimin e plotë retrospektiv.

Ndryshimet ne politikat kontabel nuk kane efekt ne pasqyrat financiare te shoqerise.

4. Drejtimi i rrezikut financiar

Funksioni i drejtimit të rrezikut brenda Shoqërisë është realizuar për rreziqet financiare (kreditor, tregu, monedha, likuiditeti dhe norma e interesit), rrezikun operacional (siç është rreziku mjedisor) dhe rrezikun ligjor. Objektivat kryesore të funksionit të drejtimit të rrezikut janë përcaktimi i kufijve të rrezikut dhe sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe atij ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar këto rreziqe.

Zhvillimet aktuale

